



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT**  
*(Përfundimtar)*

**PËR**

**INSPEKTIMIN E PËRGJITHSHËM**

**NË LIDHJE ME LIGJSHMËRINË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL**

**KËSHILLI I QARKUT KUKËS**

**Tiranë, Tetor 2015**

## RAPORT

### *“Për inspektimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil Këshilli i Qarkut Kukës”*

#### Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pikat 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me Vendimin nr. 66, datë 02.07.2015 “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Këshilli i Qarkut Kukës”, vendosi fillimin e inspektimit të përgjithshëm në Këshillin e Qarkut Kukës.

Procesi u realizua sipas programit të inspektimit nr. 480/1 prot., datë 02.07.2015, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 480/2 prot., datë 02.07.2015 “Njoftim për fillimin e inspektimit”.

Objekti i inspektimit në këtë institucion është i përgjithshëm duke u përcaktuar një objekt i gjerë kontrolli, që përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilat, evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil; deklarimin e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; respektimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil; hartimin e formularit të përshkrimit të punës; miratimin e planit vjetor të pranimin në shërbimin civil; plotësimi i pozicioneve të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm; pezullimin nga shërbimi civil; realizimin e vlerësimeve të punës për nëpunësit civil; kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove, etj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i inspektimit, i përbërë nga inspektorët Saimir Muçmataj, Atalvin Niço dhe Stela Ndoka, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, Ilia Kukumi, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e inspektimit në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Kukës. Materiali u dërgua në institucionin e inspektuar, me shkresën nr. 480/3 prot., datë 23.09.2015, “Dërgohet projektraporti i inspektimit në institucionin e Këshillin e Qarkut Kukës, në lidhje me procesin e ristrukturimit”.

Pasi u njoh me problematikën e evidentuar nga grupi i inspektimit, projektraporti u nënshkrua nga Kryetari i Këshillit të Qarkut Kukës dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Financës dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në këtë institucion. Me shkresën nr. 1016 prot., datë 08.10.2015, “Observacion mbi projektraportin e mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil”, institucioni ka dërguar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, materialin e nënshkruar nga personat përgjegjës si dhe vërejtjet e shoqëruara me dokumentet përkatëse që provojnë pretendimet e tyre.

Pasi vlerësoi observacionet e paraqitura nga institucioni i inspektuar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ka materializuar qëndrimin në lidhje me to, në përmbajtjen e raportit përfundimtar të inspektimit, në kapitujt përkatës.

### **Oëllimi i inspektimit:**

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjëseve për menaxhimin e burimeve njerëzore, njësisë së burimeve njerëzore, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi dhe shkelje të ligjit në administrimin e shërbimit civil.
- Paralajmërimin e personave përgjegjës dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

### **Objekti i inspektimit:**

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore për të përfituar statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
  - 2.1. Nëpunës, të pranuar në shërbimin civil si “nëpunës ekzistues” sipas përcaktimeve të nenit 67/3 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”.
  - 2.2. Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë të emëruar me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.
  - 2.3. Nëpunës të pranuar në shërbimin civil sipas procedurave konkurruese të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
3. Hartimi i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil.
4. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues*).
5. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit. Procesi i ristrukturimit (*zbatimi i kërkesave të nenit 50 e vijues të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij*).
  - 5.1. Procesi i ristrukturimit.
  - 5.2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes.
6. Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.

## **Metodologjia e inspektimit:**

Grupi i inspektimit, verifikoi dosjen individuale për çdo të punësuar në pozicione të shërbimit civil si dhe çdo dokument tjetër lidhur me çështje të personelit që rregullohen shprehimisht nga ligji “Për nëpunësin civil”.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të inspektimit, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim dhe bashkëbisedim me titullarin e institucionit ku u bisedua dhe u ra dakord, për objektin dhe drejtimit e inspektimit, si dhe dokumentacionin shkresor që do të vihej në dispozicion të grupit të inspektimit. Drejtori i Drejtorisë Juridike, Financës dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore u caktua si person kontakti me grupin e punës;
- Grupi i punës shqyrtoi pozicionet e shërbimit civil, sipas organigramës dhe organikës së hollësishme të institucionit;
- Verifikoi dosjet individuale të çdo nëpunësi të punësuar në vendet e shërbimit civil, librezat e punës, mënyrën e fillimit të marrëdhënieve financiare, si dhe çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil;
- Kontrollon të dhënat profesionale të çdo nëpunësi civil, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës (*nivelin e edukimit, fushën kryesore të studimeve, përvojën në punë etj.*), për të vlerësuar nëse nëpunësit e punësuar në pozicionet e shërbimit civil i plotësonin ose jo kërkesat e posaçme për vendin e tyre të punës.
- U verifikuan materialet që pasqyrojnë planin vjetor të pranimin në shërbimin civil, rastet e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, të realizuara pas hyrjes në fuqi të ligjit për nëpunësin civil, vlerësimet e punës dhe shënimet që shoqërojnë ato, etj.
- Njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore iu kërkua që të paraqiste problemet me të cilat ajo ndeshet në praktikën e punës së përditshme me qëllim që të asistohen teknikisht për zgjidhjen e drejtë të tyre.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete (*Aneksi 1, Aneksi 2, dhe Aneksi 3*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti.

## **Përmbajtja e Raportit:**

- 1) **Si është kuptuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit.**

Këshilli i Qarkut Kukës, është organ i qeverisjes vendore, statusi i tij përcaktohet në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004. Në Kreun II, neni 5/4, të këtij ligji, përcakton qarkun si njësi e nivelit të dytë të qeverisjes vendore.

Për këtë arsye, hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e përfshin këtë institucion në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil. Në nenin 2, të ligjit është e përcaktuar në mënyrë të shprehur se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore. Për rrjedhojë, Këshilli i Qarkut Kukës është institucion që përfshihet në fushën e shërbimit civil.

Republika e Shqipërisë ndahet në 12 njësi administrative të quajtura "Qark" dhe administrata e tyre funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli Qarkut, sipas parashikimeve të nenit 54, shkronja "d", të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut.

Në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, (në datë 26.02.2014), institucioni i inspektuar funksiononte sipas strukturës miratuar me vendimin nr. 2, datë 06.02.2014, "Për miratimin e Strukturës së administratës të Këshillit të Qarkut Kukës".

Gjithashtu, në strukturën organizative të Qarkut Kukës janë dhe 5 pozicione pune pjesë e shërbimit civil si funksione të deleguara nga Ministria e Bujqësisë. Këto pozicione funksionojnë sipas strukturës për funksionet e deleguara miratuar me VKM nr. 64, datë 23.01.2003 "Për përcaktimin e punonjësve të seksioneve të administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në Këshillat e Qarqeve dhe të zyrave të menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës, në Komuna dhe/ose Bashki", i ndryshuar me VKM nr. 383, datë 28.06.2007, në mbështetje të nenit 4, të ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001, "Për krijimin dhe funksionimin dhe mbrojtjen e tokës".

Bazuar sa më lart, Këshilli Qarkut Kukës kishte gjithsej 52 vende pune (47 funksione të qarkut + 5 funksione të deleguara), nga ku: 5 funksionarë politikë, 5 pozicione administrativë, 2 pozicione pune pjesë e strukturës me kontratë të përkohshme (punonjës që paguhen me të ardhurat e institucionit dhe nuk përfshihet në shërbimin civil) dhe 40 pozicione pune pjesë e shërbimit civil (35 pozicione të qarkut dhe 5 pozicione të deleguar).

Në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, për 40 pozicionet pjesë e shërbimit civil kishim 25 nëpunës civil të konfirmuar + 6 nëpunës civil në periudhë prove të konfirmuar + 9 vende vakane.

Me vendimin nr. 25, datë 11.07.2014, "Për një ndryshim në vendimin nr. 2, datë 06.02.2014 "Për miratimin e Strukturës së administratës të Këshillit të Qarkut Kukës", është shtuar një pozicion me kontratë të përkohshme (punonjës që paguhet me të ardhurat e institucionit dhe nuk përfshihet në shërbimin civil), duke çuar në 53, numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës.

Këshilli i Qarkut Kukës, me vendimin nr. 47, datë 26.12.2014, "Për miratimin e Strukturës së administratës të Këshillit të Qarkut Kukës", ka miratuar strukturën e administratës me gjithsej 36 vende pune, nga ku: 5 funksionarë politikë, 4 pozicione administrativë, 2 pozicione pune pjesë e strukturës me kontratë të përkohshme (punonjës që paguhen me të ardhurat e institucionit dhe nuk përfshihet në shërbimin civil) dhe 25 pozicione pune pjesë e shërbimit civil (20 pozicione të qarkut dhe 5 pozicione të deleguar).

Aktualisht, institucioni i inspektuar funksionon sipas strukturës së administratës miratuar me vendimin nr. 2, datë 28.01.2015, "Për miratimin e Strukturës të administratës, nivelit të pagave si dhe masës së shpërblimit mujor të antarëve të Këshillit të Qarkut Kukës", i ndryshuar me vendimin nr. 5, datë 15.04.2015, "Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e administratës së Këshillit Qarkut Kukës" dhe ka gjithsej 27 vende pune, të ndara si më poshtë:

- numri i funksionarëve politikë është 5 ( Kryetar + 1 N/kryetar + 1 sekretar i këshillit të qarkut + 1 këshilltar për marrëdhëniet në jashtë, qeverisjen vendore dhe OJF + 1 sekretar i kryetarit dhe marrëdhënieve me publikun);
- numri i punonjësve administrativë është 4 (1 arkëtar, arkivi dhe magazinier + 1 shofer administrate + 1 roje operative + 1 sanitare);

- numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, pjesë e strukturës që paguhen me të ardhurat e institucionit dhe nuk përfshihet në shërbimin civil është 2 (2 i inspektorë në sektorin e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës pranë DAMT-së); dhe,
- numri i nëpunësve civilë është 18 (13 nëpunës civil të KQK + 5 nëpunës civil, me funksion të deleguar).

Grupimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nisur nga kategoria dhe klasa sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, paraqitet në këtë mënyrë:

Nr.	Pozicionet e shërbimit civil të klasifikuara sipas kategorisë dhe klasës	Emërtesa e pozicionit të punës sipas strukturës së miratuar	Numri i pozicioneve të punës sipas kategorisë dhe klasës
1.	Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues	Drejtor Drejtorie II-b	4 pozicione sipas strukturës
2.	Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues	Shef sektori III-a/1 Përgjegjës ZAMT IV-a	1 pozicion sipas strukturës 3 pozicione sipas strukturës
3.	Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive	Specialistë III-b Specialistë IV-a Specialistë IV-b	8 pozicione sipas strukturës 1 pozicione sipas strukturës 1 pozicione sipas strukturës
<b>Pozicione të shërbimit civil gjithsej</b>			<b>18</b>

**Konkluzion:** Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstaton se, struktura organizative për administratën e institucionit të inspektuar është e organizuar mbështetur në parimin e hierarkisë, në përmbajtjen e saj prezantohen niveli i funksionarëve politikë, nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë. Numri i punonjësve për çdo njësi organizative është brenda kufirit të miratuar.

- 2) **Plotësimi i kushteve ligjore për të përfitur statusin e nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**

*Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e inspektimit sipas strukturës organizative aktuale.*

Nisur nga fakti që Këshilli Qarkut Kukës, është institucion që përfshihet në fushën e shërbimit civil, deklarimi i statusit të punësimit për çdo punonjës të këtij institucioni, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;
- pika 4, “nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;
- pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësta përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.

Po kështu, në vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013

*"Për nëpunësin civil", Kreu II, "Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet", pika 1, është përcaktuar se:*

*"Nëpunës civilë", sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".*

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarimin e statusit të punësimit, u verifikuan dhe analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën e institucionit e cila është aktualisht në fuqi; listëprezencën e muajit shkurt 2014; dokumentacionin që pasqyron punësimin në një pozicion të shërbimit civil; kohëzgjatjen e periudhës së punësimit; dokumentacionin që vërteton procedurën e marrjes në punë si dhe dokumentet personale të punonjësve.

Më poshtë po paraqesim mënyrën se si janë plotësuar 18 pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion.

**2.1) Nëpunës, të pranuar në shërbimin civil si "nëpunës ekzistues" sipas përcaktimeve të nenit 67/3 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësit civil".**

Këshilli i Qarkut Kukës, është institucion që ka qenë pjesë e shërbimit civil edhe me ligjin nr.8549/1999, "Statusi i nëpunësit civil". Nga këqyrja e dokumentacionit të administruar në dosjen personale të nëpunësve të punësuar në pozicione të shërbimit civil rezulton se:

- Në Këshillin e Qarkut Kukës, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, (në datë 26.02.2014) janë evidentuar 8 punonjës të cilët në bazë të nenit 67/3 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", kategorizohen "nëpunës civil ekzistues".

Në mënyrë nominale, bëhet fjalë për punonjësit e mëposhtëm:

1. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 4, datë 16.01.2001, të Kryetarit, emërohet me detyrë *Jurist*. Me aktin nr. 23 prot., datë 26.05.2003, të Kryetarit, emërohet nëpunës civil me detyrë *Drejtor* në Drejtorinë Juridike. Me aktin nr. 3, datë 23.07.2014, deklarohet statusi i punësimit, nëpunës civil i konfirmuar. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Qarkut Kukës nr. 47, datë 26.12.2014, "Për miratimin e strukturës dhe administratës të Këshillit të Qarkut Kukës" dhe me propozim të Komisionit të Ristrukturimit, me aktin nr. 2, datë 06.01.2015, emërohet në të njëjtin pozicion.

2. \*\*\*\*\* me nr. 3, datë 02.04.2007, emërohet në pozicionin *Drejtor* në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale. Më pas me urdhërin nr. 8, datë 03.01.2013, "Për emërim në shërbimin civil" emërohet *Drejtor* në Drejtorinë e Shërbimit Rajonal. Me aktin nr. 1, datë 23.07.2014, deklarohet nëpunës civil nga njësia përgjegjëse. Së fundmi, me urdhërin nr. 6, datë 06.01.2015, emërohet *Drejtor* në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Planifikimit të Territorit.

3. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 24, datë 10.4.2012, emërohet specialist për Administrimin e Regjistrimit të Territorit pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrillit të Zhvillimit të Territorit. Në vazhdim, me urdhërin nr. 6, datë 30.01.2013, emërohet në shërbim civil në pozicionin specialist për Administrim e Regjistrimit të Territorit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrillit të Zhvillimit të Territorit. Me aktin nr. 19, datë 23.07.2014 deklarohet statusi i punësimit, nëpunës civil në

pozicionin Specialist i Administrimit të Regjistrimit të Territorit pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrillit të Zhvillimit të Territorit. Me urdhërin nr. 18, datë 07.01.2015, "Për lirim dhe emërim në detyrë" emërohet Specialist i Planifikimit të Territorit DSHPT, pas ristrukturimit në Këshillin e Qarkut Kukës.

4. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 64, datë 30.11.2011 "Për lirim dhe emërim në detyrë" emërohet Specialist për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrillit të Zhvillimit të Territorit. Me urdhërin nr. 5, datë 03.01.2013, emërohet në shërbim civil. Me akti nr. 18, datë 23.07.2014 deklarohet statusi i punësimit, nëpunës civil në pozicionin Specialist për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrillit të Zhvillimit të Territorit. Me urdhërin nr. 23, datë 07.01.2015 "Për lirim dhe emërim në detyrë", emërohet Specialist i Mjedisit dhe Turizmit në DSHPT, pas ristrukturimit në Këshillin e Qarkut Kukës.

5. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 26, datë 29.04.2009, "Për komandim në detyrë", komandohet Specialist i Infrastrukturës Inxhinierike dhe i Vlerësimit të Inpaktit në Mjedis pranë Drejtorisë Urbanistikës. Me urdhërin nr. 66, datë 30.11.2011, emërohet specialist i Fushës së Transportit dhe Emergjencave pranë Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale. Urdhëri nr. 9, datë 03.01.2013 "Për emërim në shërbimin civil" emërohet në pozicionin e mësipërm. Me aktin nr. 21 datë 23.07.2014 deklarohet statusi i punësimit, nëpunës civil nga njësia përgjegjëse në të njëjtin pozicion. Me urdhërin e fundit nr. 21, datë 07.01.2015, emërohet në detyrë specialist i Emergjencave dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Planifikimit të Territorit, pas ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Kukës.

6. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 23, datë 25.11.2005, emërohet "Përgjegjës i Seksionit të Administrimit të Tokës" pranë Këshillit të Qarkut Kukës. Me urdhërin nr. 4, datë 05.01.2011, emërohet në shërbim civil, në pozicionin "Drejtor i Drejtorisë Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës", pranë Këshillit të Qarkut Kukës. Me aktin nr. 6, datë 23.07.2014, deklarohet statusi i punësimit, nëpunës civil në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues.

7. \*\*\*\*\* me urdhëri nr. 11, datë 01.04.2008, emërohet në shërbim civil në pozicionin "Specialist" në zyrën e DAMT Kukës. Me aktin nr. 29, datë 23.07.2014 deklarohet statusi i punësimit, nëpunës civil nga njësia përgjegjëse, në të njëjtin pozicion pune.

8. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 86, datë 19.11.2007, emërohet në pozicionin "Specialist" pranë Drejtorisë së Urbanistikës. Në vijim, me urdhërin nr. 65, datë 30.11.2011, "Për lirim dhe emërim në detyrë", emërohet "Specialist për Kontrollin dhe Zhvillimin e Tokës" pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrillit të Zhvillimit të Territorit. Me urdhërin nr. 4, datë 03.01.2013, emërohet në shërbim civil. Me aktin nr. 17, datë 23.07.2014, deklarohet statusi i punësimit, nëpunës civil në pozicionin Specialist për Kontrollin dhe Zhvillimin e Tokës pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrillit të Zhvillimit të Territorit.

Me urdhërin nr. 34, datë 07.01.15, "Për lirim nga detyra", lirohet nga pozicioni i mëparshëm, pas ristrukturimit me vendimin nr. 47, datë 26.12.2014, të Këshillin e Qarkut Kukës. Me urdhërin nr.32, datë 27.03.2015, emërohet Përgjegjës e Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Tropojë.

2.2) Vende pune të plotësuara nga nëpunës që janë të emëruar me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.



Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil, (në datë 26.02.2014) në këtë institucion janë plotësuar vende pune, pjesë e shërbimit civil, nëpërmjet akteve të përkohëshme të emërit, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, sikurse përcaktohej në nenin 13 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil".

Megjithëse kjo dispozitë ligjore përcaktonte konkurrimin, si të vetmen mënyrë të rekrutimit në shërbimin civil, marrëdhëniet e punës për këta punonjës, kanë vazhduar të rregullohen sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë.

Nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4 të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezultoi se:

- 6 punonjës ekzistues, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil, ishin të punësuar në vende pune pjesë e shërbimit civil, për një periudhë më shumë se 1 vit.

Për këtë grup punonjësish, njësia e burimeve njerëzore (Drejtoria Juridike, Financës dhe Menaxhimit Burimeve Njerëzore) ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë.

Aktet, të cilat materializojnë këtë proces, janë të evidentuara në tabelën Aneksi nr. I "Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të punësuar me emërim të përkohshëm (data 26.02.2014)".

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në këtë mënyrë janë:

Nr.	Nëpunësi	Emërtesa e pozicionit të punës	Akti i fillimit të marrëdhënies së punës
1.	*****	Drejtor, Drejtoria e Tek. së Infor., Prog. dhe Statistikave	Urdhri nr. 60, datë 30.11.2011
2.	*****	Specialist për ëeb dhe Multimedian	Urdhri nr. 20, datë 30.03.2012
3.	*****	Specialist i Administrimit të Rrjetit IT	Urdhri nr. 19, datë 30.03.2012
4.	*****	Specialist e Programit dhe Database	Urdhri nr. 59, datë 01.12.2011
5.	*****	Përgjegjës ZAMT Kukës	Urdhri nr. 21, datë 30.06.2006
6.	*****	Përgjegjës ZAMT Has	Urdhri nr. 18, datë 01.06.2006

- 2 punonjës, ekzistues në momentin e fillimit të efekteve të ligjit 152/2013, u gjetën të punësuar në vende pune pjesë e shërbimit civil, për një periudhë më pak se 1 vit.

Për këtë grup punonjësish, me të drejtë, njësia e burimeve njerëzore (Drejtoria Juridike, Financës dhe Menaxhimit Burimeve Njerëzore), ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove, duke iu filluar periudha e provës në datë 26.02.2014.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove në këtë kategori janë:

Nr.	Nëpunësi	Emërtesa e pozicionit të punës	Akti i fillimit të marrëdhënies së punës
1.	*****	Jurist	Urdhri nr. 32, datë 21.02.2014
2.	*****	Specialist i Administratës dhe Logjistikës	Urdhri nr. 17, datë 21.02.2014

**Konkluzion:** Duke analizuar dokumentacionin që materializon procesin e deklarimit të statusit të punësimit, Komisioneri arrin në konkluzionin se për 16 nëpunësit e analizuar më sipër, procedura e

deklarimit të statusit të punësimit është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 67 pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar (shih të dhënat e traftuara në mënyrë analitike në Aneksin nr. 1 dhe Aneksin nr. 2, që janë pjesë e këtij materiali).

Ndërkohë, konstatohet se në **1 rast**, njësia e burimeve njerëzore në procedurat e ndjekura për deklarimin e statusit të punësimit nuk ka respektuar kërkesat e ligjit, konkretisht:

Nëpunësja \*\*\*\*\* sipas dokumentacionit që administrohet në dosjen e personelit dhe që është këqyrrur nga grupi i punës, rezulton se, me aktin nr. 76 prot., datë 26.12.2011, të Kryetarit, dhe me kontratën nr. 8 prot., datë 26.12.2011, është emëruar në pozicionin "Specialist në Hartimin dhe Zbatimin e Strategjive", në Drejtorinë e Hartimit dhe Kordinimit të Projekteve.

Me aktin nr. 2, datë 03.01.2013, të Kryetarit, është emëruar në kategorinë "nëpunës civil në periudhë prove", pasi u shpall fituese e konkurimit për detyrën e mësipërme (që e ushtronte përkohësisht me akt të thjeshtë emërimi). Me aktin e konfirmimit të nëpunësit civil, (i cili nuk ka nr. protokoll) të datës 08.01.2014, konfirmohet si nëpunëse civile në këtë pozicion. Më tej, në zbatim të Vendimit, nr. 47, datë 26.12.2014, të Këshillit të Qarkut Kukës "Për miratimin e strukturës dhe administratës të Këshillit të Qarkut Kukës" dhe me propozim të Komisionit të Ristrukturimit, me aktin nr. 3 prot., datë 06.01.2015, emërohet në pozicion "Shefe e Sektorit të Financës".

Ndërkohë, rezulton se me shkresën nr. 1015 prot., datë 02.10.2015, Këshilli i Qarkut Kukës ka paraqitur observacione, të shoqëruar me disa prova shkresore, për të mbështetur pretendimet e tij, në lidhje me statusin e punonjësës \*\*\*\*\* .

Nga ana e institucionit, kërkohet rishikimi i konkluzioneve që kanë lidhje me këtë punonjëse, pikërisht në kapitullin 5.1, "Procesi i Ristrukturimit", në rubrikën "konkluzione", pika e dytë, të projektraportit, ku në mënyrë të shprehur, vlerësohet se:

"Propozimi i Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e punonjësës \*\*\*\*\* nga pozicioni "Specialist në Hartimin dhe Zbatimin e Strategjive në Drejtorinë së Hartimit dhe Kordinimit të Projekteve" në pozicion "Shef i Sektorit të Financës", miratuar me aktin nr. 3, prot., datë 06.01.2015, të Kryetarit, është bërë pa respektuar kërkesat e ligjit. Sipas dispozitave të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, një nëpunës civil për të kaluar nga kategoria ekzekutive "Specialist" në kategorinë e nëpunësit të nivelit të ulët drejtues "Shef/Përgjegjës sektori", duhet të aplikohen procedurat e ngritjes në detyrë. Ky propozim i Komisionit të Ristrukturimit dhe urdhëri për emërimin e kësaj nëpunëseje me detyrë "Shef i Sektorit të Financës" nuk është kryer në përputhje me nenin 50, pika 1, e ligjit. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ku citohet se "Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori"."

Aktualisht ky paragraf është ri vlerësuar nga Komisioneri, mbi bazën e provave të reja të paraqitura nga institucioni dhe është arritur në këto konkluzione:

Punonjësja \*\*\*\*\* është konfirmuar si nëpunëse civile në pozicionin "Specialist në Hartimin dhe Zbatimin e Strategjive", në Drejtorinë e Hartimit dhe Koordinimit të Projekteve, në datën 08.01.2014, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8549/1999, "Statusi i nëpunësit civil".

Me urdhrin nr. 23, datë 28.02.2014, (Mardhënia financiare është përcaktuar të filloj në datën 03.03.2014), është emëruar "Përgjegjëse e Zyrës së Financës", në Drejtorinë Juridike dhe Financës. Më tej me aktin nr. 24, datë 23.07.2014, është emëruar si nëpunëse civile në periudhë prove, në

pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, pranë Drejtorisë Juridike dhe Financës dhe me aktin nr. 3, datë 30.07.2015, është konfirmuar si nëpunëse civile në këtë pozicion.

Rezulton se, në zbatim të Vendimit nr. 47, datë 26.12.2014, të Këshillit të Qarkut Kukës “Përmiratimin e strukturës dhe administratës të Këshillit të Qarkut Kukës”, dhe me propozim të Komisionit të Ristrukturimit, me aktin nr. 3, datë 06.01.2015, kjo nëpunëse me detyrë “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”, në Drejtorinë Juridike dhe Financës, emërohet “Shefe e Sektorit të Financës”, në Drejtorinë Juridike, Financës dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Kategoria mbetet e njëjtë, kemi të bëjmë vetëm me ndryshim emërtese).

Nga analiza ligjore e akteve administrative më sipër dhe procedurave të ndjekura nga njësia e burimeve njerëzore të institucionit të inspektuar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, konstaton se rasti në fjalë, vlerësohet si objekt i institutit të ngritjes në detyrë. Në këtë këndvështrim, akti administrativ i nxjerrë nga ana e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Kukës, për emërimin në detyrë të nëpunëses në fjalë, në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës së Financës në Drejtorinë Juridike dhe Financës”, duhet të kishte dalë në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë, pasi kjo punonjëse është nëpunëse civile e konfirmuar në kategorinë ekzekutive “Specialist”.

Rezulton se data e daljes së aktit të emërimit në një pozicion të nivelit të ulët drejtues, është 28.02.2014 dhe ndërkohë, efektet financiare fillojnë në datën 03.03.2014, ç’ka do të thotë se përkojnë me momentin kur kishin filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014).

Në këto rrethana, për kalimin nga kategoria ekzekutive në kategorinë e nivelit të ulët drejtuese (siç është kalimi nga “Specialist” në “Përgjegjës i Zyrës” në këtë rast), institucioni i inspektuar duhet të zbatonte të gjitha rregullat për procedurën e ngritjes në detyrë siç parashikohet në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Më tej, për të njëjtat arsye, edhe aktet që shoqërojnë aktin e emërimit, si akti administrativ nr.24, datë 23.07.2014, që e emëron si nëpunës civil në periudhë prove, si dhe akti nr. 3, datë 30.07.2015, që e konfirmon si nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, pranë Drejtorisë Juridike dhe Financës, janë akte të dala në kundërshtim me ligjin për shërbimin civil, pasi këto akte nuk kanë dalë si rrjedhojë e një procedure të rregullt ligjore, në këtë rast konkurrimi.

**Konkluzione:** Për të gjitha arsyet e përmendura më sipër, Komisioneri vlerëson se njësia përgjegjëse duhet të rregullojë situatën duke kryer këto veprime administrative:

- Të revokojë aktin administrativ nr. 23, datë 28.02.2014, që emëron punonjësen \*\*\*\*\* në detyrën “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”, në Drejtorinë Juridike dhe Financës; aktin administrativ nr. 24, datë 23.07.2014, që e emëron këtë punonjëse si “nëpunës civil në periudhë prove” dhe aktin nr. 3, datë 30.07.2015, që e konfirmon si “nëpunës civil”, si akte të dala në kundërshtim me përcaktimet e nenit 22 e vijues të ligjit nr. 30/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi këto akte nuk kanë dalë si rezultat i një procedure të rregullt rekrutimi, në këtë rast konkurrimi.
- Të revokojë aktin administrativ nr. 3, datë 06.01.2015, që emëron nëpunësen në fjalë mbas procesit të restrukturimit në pozicion “Shef i sektorit të financës”, në Drejtorinë Juridike, Financës dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pasi kjo punonjëse nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil në nivelin “përgjegjës sektori”.

- Njësia e burimeve njerëzore, si njësia përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit, duhet të shpallë si vend të lirë pozicionin e punës “*Shef i sektorit të financës*” në Drejtorinë Juridike, Financës dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe të kujdeset për t’a plotësuar atë nëpërmjet procedurave të ngritjes në detyrë. Nëpunësja në fjalë, nuk ka asnjë pengesë ligjore, që nëse i përmbush kërkesat e vendit të punës, të kandidojë për këtë pozicion pune, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

### **2.3) Nëpunës të pranuar në shërbimin civil, rishtas, sipas procedurave konkurruese të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.**

Konstatohet se 1 nëpunës civil është pranuar në shërbimin civil sipas procedurave konkurruese të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkretisht, bëhet fjalë për nëpunësin \*\*\*\*\* dhe sipas dokumentacionit të këqyrrur në dosjen e tij personale, si dhe në dosjen që materializon procedurën e konkurrimit rezulton se:

Ky nëpunës ka marrë pjesë në konkurimin e shpallur nga Këshilli i Qarkut Kukës, për pozicionin vakant “*Specialist i burimeve njerëzore*”, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konstatohet se shpallja e konkurimit është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 25 dhe të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe të Kreut VI dhe VII, të Vendimit nr.143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”.

Rezulton se Komisioni i Përhershëm i Pranimit është krijuar me urdhërin nr. 106 prot., datë 10.09.2014, sipas përcaktimit të bërë në nenin 26 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikave 4 dhe 5, të Kreut VII të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave dhe vlerësimi i kandidatit është bërë sipas përcaktimit të pikës 6, të Kreut VII, të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave.

Në përfundim Komisioni ka shpallur fitues kandidatin në fjalë me 86.8 pikë në total dhe me urdhrin nr. 117, datë 30.09.2014, është emëruar në pozicionin “*Specialist i burimeve njerëzore*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, kategoria III-b, për një periudhë prove një vit.

### **3) Hartimi i përshkrimit të punës për pozicionet e shërbimit civil.**

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të inspektimit, u verifikuan formularët e përshkrimit të punës për të parë se si janë zbatuar kërkesat e Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”.

Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen për hartimin e përshkrimeve të punës, nëpunësit përgjegjës për hartimin e këtyre akteve, strukturën përgjegjëse për vlerësimin e bazueshmërisë së tyre në ligjin specifik dhe formatin e miratuar, organin që ka kompetencën për miratimin e tyre, si dhe depozitimin e tyre pranë njësisë përgjegjëse.

Nga procesi i verifikimit u konstatua se, për të gjitha pozicionet e punës të kësaj njësie vendore kanë qënë të hartuara përshkrimet e punës, ndërsa për pozicionet pjesë e shërbimit civil janë hartuar përshkrime pune të reja.

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore mbështetur në legjislacionin specifik, ka mbledhur informacionin për çdo pozicion pune dhe pas një analize të tij, ka përcaktuar në mënyrë të qartë detyrat, përgjegjësitë dhe kërkesat e veçanta për çdo pozicion apo grup pozicionesh.

Nga verifikimi rezultoi se në përshkrimet e punës janë përfshirë të gjithë elementet, sipas formatit të miratuar, siç janë të dhënat për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës dhe kërkesat e posaçme.

Përshkrimet e punës të hartuara sipas formatit standart të miratuar dhe në mbështetje të kërkesave të pikës 4/ 2/10 të Udhëzimit nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, janë nënshkruar nga nëpunësi civil që punon në pozicionin për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, përgjegjësi i sektorit përkatës dhe janë miratuar nga drejtuesi i institucionit i cili paraqitet në cilësinë e prorit direkt.

**Konkluzion:** Sa me sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore është kuptuar dhe zbatuar drejt legjislacioni specifik edhe për këtë aspekt të shërbimit civil dhe përshkrimet e punës në përmbajtjen e tyre janë plotësuar në përputhje të plotë me parashikimet e akteve nënligjore dhe pa mangësi në anën formale.

**4) Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.**

Instituti i vlerësimit të punës dhe mënyra se si materializohet procedura për aplikimin e tij si dhe se si përmbushen detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur nëpunësve kompetentë të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues*), është një aspekt shumë i rëndësishëm i administrimit të burimeve njerëzore.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të inspektimit, u verifikua procesi i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2014, për nëpunësit civilë të Këshillit të Qarkut Kukës. Më konkretisht, u verifikua nëse procesi i vlerësimit është kryer në mbështetje dhe në respektim të përcaktimeve të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”.

Nga verifikimi u konstatua se në institucionin e inspektuar janë bërë vlerësimet e rezultateve në punë për vitin 2014 për nëpunësit të punësuar në pozicione të shërbimit civil, por në këtë proces administrativ u vërejtën mospërputhjet e mëposhtme:

- vlerësimet e rezultateve në punë për vitin 2014 nuk janë kryer sipas formularit të vlerësimit të përshkruar në kreun IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”.
- Në vlerësimet për vitin 2014 nuk janë përfshirë edhe muajt nëntor dhe dhjetor të vitit 2013, ashtu si përcaktohet në pikën 2, kreu VI, i VKM nr. 109, datë 26.2.2014.

Në këtë institucion konstatohet se njësisia e burimeve njerëzore, ka përdorur një formular vlerësimi që e ka konceptuar vetë, për vlerësimin e nëpunësve civil, i cili rezulton i ndryshëm në formë dhe përmbajtje, nga formulari zyrtar, i miratuar me akt nënligjor.

Nga krahasimi i formularit të vlerësimit që është aplikuar nga institucioni, me formularin e vlerësimit miratuar me Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, rezulton se:

- Procesi i vlerësimit, në përmbajtjen e tij është kryer duke u bazuar në përgjithësi, në sjelljen profesionale dhe realizimin e detyrave, por metodologjia e konceptimit dhe e pasqyrit të vlerësimit të zërave të ndryshëm, që përmban ky proces, në aktin e vlerësimit, nuk është bërë në formën që përcaktohet në kreun II, pika 8, e Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*.
- Ky formular vlerësimi nuk është kryer në bashkëpunim nga të gjithë aktorët e parashikuar nga ligji, si Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues, por vetëm nga eprori direkt që ka në vartësi nëpunësin.
- Të gjithë nëpunësit nuk janë njohur me aktin e vlerësimit të punës për të mundësuar të drejtën e tyre të ankimit në lidhje me nivelin e vlerësimit.
- Formulari i vlerësimit rezultuan vetëm në në formë elektronike, ç’ka nuk i jep mundësi vlerësuesit të bëjë arsyetimin me shkrim, për çdo vlerësim të dhënë sipas rubrikave, e për më tepër për t’u administruar më tej në dosjen e personelt.
- Në formularin e vlerësimit nuk përcaktohet periudha për të cilën nëpunësi është vlerësuar.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson përpjekjet që ka bërë njësia e burimeve njerëzore për të krijuar një sistem vlerësimi sa më objektiv, por nga ana tjetër, ky formular vlerësimi nuk përmban në vetvete kërkesat ligjore që janë të unifikuara për të gjitha institucionet e administratës publike që janë pjesë e shërbimit civil.

Duke analizuar përmbajtjen e këtij akti, si dhe mënyrën se si administrohet ky proces, arrijmë në përfundimin se nuk respektohen disa të drejta dhe detyrime ligjore të nëpunësit civil në lidhje me këtë proces të tilla si, e drejta për të marrë dijeni dhe për t’u ankuar në lidhje me procesin e vlerësimit.

Ndërkohë, mungesa e periudhës së vlerësimit, ndikon negativisht në të drejtën e nëpunësit civil për të zhvilluar sistemin e karrierës, në kushtet kur, vlerësimi i rezultateve në punë i nevojitet si kusht ligjor për të aplikuar në procedurat e ngritjes në detyrë apo lëvizjes paralele.

Po kështu, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet zyrtarëve përgjegjës për sistemin e vlerësimit, në kushtet kur në rastin konkret është kryer vetëm nga eprori direkt, anashkalon kompetencat e zyrtarëve të autorizuar nga ligji për të kontrolluar procesin, apo për të shprehur opinionin e tyre në lidhje me ecurinë në punë të secilit nëpunës si dhe nga detyrimi i vlerësuesit për të komentuar qartë dhe arsyetuar me shkrim, për secilin nga përfundimet e arritura, sipas rubrikave, veprime të domosdoshme këto, të cilat sqarojnë nivelin e vlerësimit, aspektet delikate dhe kompetente të nëpunësit civil dhe mënyrën se si duhet vepruar për përmirësimin e gjëndjes në të ardhmen.

Ndërkohë, në lidhje me konkluzionete nxjerra nga grupi i inspektimit në këtë rast, ka paraqitur observacione institucionale, duke pretenduar se procedura e vlerësimit është bërë duke marrë për bazë komponentët kryesor për verifikimin e realizimit të objektivave të përcaktuar në fillim të vitit, si dhe të kryerjes së detyrave të ngarkuara dhe se, në pjesën e formularit të vlerësimit janë të gjithë elementët e përcaktuar në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave. *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*.

Komisioneri në këtë rast, vlerëson metodat e reja të konceptuara nga njësia e burimeve njerëzore për të materializuar një vlerësim sa më objektiv në përputhje me qëllimin e vlerësimit të rezultateve në punë, por nga ana tjetër, sjell në vëmendje të njësisë së burimeve njerëzore se, procesi i vlerësimit ka nevojë të unifikohet, me qëllim që të sigurojë edhe mundësinë e nëpunësit civil për të qarkulluar në të gjithë sistemin e shërbimit civil, në përputhje me parimin e zhvillimit të karrierës. Ky proces duhet të statandartizohet duke marrë për bazë formularin tip të miratuar me akt nënligjor, që është formulari i vlerësimit nr. 2, bashkëlidhur dhe miratuar me Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*. Vlerësimi i punës nëpërmjet një formulari të miratuar, është një detyrim që rrjedh nga akti nënligjor

i cituar në paragrafin më sipër dhe si i tillë ai duhet të zbatohet nga njësia e burimeve njerëzore dhe nga subjektet e caktuara nga ligji për të kontribuar në këtë proces.

**Konkluzion:** Për gjithë sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se njësia përgjegjëse duhet të vihet në krye të procesit të vlerësimit, në përmbushje të detyrimit ligjor për të vlerësuar nëpunësit civilë në përputhje me formularin e vlerësimit nr. 2, bashkëlidhur dhe miratuar me Vendimin nr.109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave. “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”. Kjo detyrë duhet të plotësohet menjëherë, brenda afatit të caktuar në vendimin e miratimit të raportit përfundimtar të inspektimit.

5) **Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit. Transferimet e përherëshme lirimi nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit.**

Në vijim të procesit të inspektimit, një rëndësi e veçantë i është kushtuar zbatimit të kërkesave të nenit 50 e vijues të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Më poshte po e analizojmë institutin e lirimit nga shërbimi civil, sipas aspekteve të veçanta nga të cilat përbëhet aplikimi i tij në praktikë.

5.1) **Procesi i ristrukturimit**

Baza ligjore dhe kriteret mbi të cilat është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit (aktet e lirimit të nëpunësve që u është shkurtuar pozicioni i punës dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për pozicionin e ri të punës sipas përshkrimeve të reja), nga ana e njësisë përgjegjëse, janë:

- Kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Kërkesat e kreut III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përherëshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave;
- Përcaktimet e Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave.

Nga shqyrtimi i materialeve shkresore të vëna në dispozicion nga ana e personit të kontaktit gjatë vizitës në subjekt, në rrugë elektronike apo korrespondencë zyrtare, rezultoi se:

➤ **Ndryshimet e strukturës së administratës së Këshillit të Qarkut Kukës**

Në datën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe para procesit të ristrukturimit, Këshilli i Qarkut Kukës funksiononte sipas strukturës organizative miratuar me vendimin nr. 2, datë 06.02.2014, “Për miratimin e Strukturës së administratës të Këshillit të Qarkut Kukës”, të ndryshuar.

Siç është shpjeguar dhe më lartë, kjo strukturë parashikonte gjithsej **53** vende pune, ndër ndër të cilat **40 pozicione pune përfshiheshin në shërbimin civil (25 nëpunës civil të konfirmuar + 6 nëpunës civil në periudhë prove të konfirmuar + 1 nëpunës civil në periudhë prove, emëruar me konkurim pas hyrjes në fuqi të ligjit për nëpunësin civil + 8 vende vakante).**

Për shkak të reduktimit të buxhetit, miratuar me ligjin nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Këshilli i Qarkut Kukës, brenda 1 muaji, ka miratuar njëra pas tjetrës, dy struktura organizative, e konkretisht:

- Struktura e administratës miratuar me vendimin nr. 47, datë 26.12.2014, "Për miratimin e Strukturës së administratës të Këshillit të Qarkut Kukës"; dhe pas një muaji,
- Struktura e administratës miratuar me vendimin nr. 2, datë 28.01.2015, "Për miratimin e Strukturës të administratës, nivelit të pagave si dhe masës së shpërblimit mujor të antarëve të Këshillit të Qarkut Kukës"

Me vendimin nr. 47, datë 26.12.2014, "Për miratimin e Strukturës së administratës të Këshillit të Qarkut Kukës", struktura e administratës parashikohej të kishte **36** pozicione pune, nga ku: **5** funksionarë politikë, **4** pozicione administrative shërbimi, **2** pozicione pune pjesë e strukturës me kontratë të përkohshme dhe **25 pozicione pune pjesë e shërbimit civil** (20 pozicione të qarkut dhe 5 pozicione të deleguar). Ky vendim i Këshillit të Qarkut, në raport me strukturën e mëparshme të miratuar me Vendimin nr. 2, datë 06.02.2014, "Për miratimin e Strukturës së administratës të Këshillit të Qarkut Kukës", solli shkurtimin e **22** pozicioneve të punës në përgjithësi dhe **15** pozicioneve në shërbimin civil.

Konkretisht, me vendimin nr. 47, datë 26.12.2014, "Për miratimin e Strukturës së administratës të Këshillit të Qarkut Kukës", Këshilli i Qarkut Kukës pësoi këto ndryshime:

Tabelë: Struktura para ristrukturimit, miratuar me vendimin nr. 2, datë 06.02.2014, i ndryshuar dhe ndryshimet e që solli struktura miratuar me vendimin nr. 47, datë 26.12.2014.

<b>I. FUNKSIONE TË QARKUT</b>			
Drejtoritë/ Sektorët	Nr. Pers.	Emërtesa e pozicionit të punës	Ndryshimet e bëra me VKQ nr. 47, dt. 26.12.14
<b>1</b>	1	Kryetar	
	1	N/Kryetar	
	1	Sekretar i K/Qarkut	
	1	Keshilltar per M.me Jashtë, Q.Vendore dhe OJF	
Këshilltar i Kryetarit	1	Sekretare e Kryetarit dhe Marrëdhënieve me Publikun	
	1		
<b>2</b>	1	Drejtor	Kjo agjensi u shkri me vendimin nr. 47, datë 26.12.2014.
	1	Specialist per zbatimin e strategjive dhe investimeve	
	1	Specialist per projektet sociale dhe mjedisit	
	1	Specialist per Qëndrën e Informacionit Turistik	
Nëpunësa civilë - total		<b>4</b>	
<b>3</b>	1	Drejtor	Drejtorja Juridike dhe Finances u bashkua me Drejtorin e Menaxhimit te Burimeve Njerezore.
	1	Specialist	
	1	Pergjegjes i Zyres Finances	
	1	Inspektor	
Nëpunësa civilë - total		<b>4</b>	
<b>4</b>	1	Drejtor	Në këtë drejtori u suprimua vetëm një pozicion "Specialist"
	1	Specialist i programimit dhe database	
	1	Specialist per statistikat dhe ëbsite	
	1	Specialist i administrimit te rrjetit	
	1	Specialist per multimedian dhe hardëare	
Nëpunësa civilë - total		<b>5</b>	
<b>5</b>	1	Drejtor	Kjo Drejtori u shkri me ligjin nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".
	1	Specialist per kontrollin dhe zhvillimin e tokes	
	1	Specialist per mbrojtjen dhe permirsimin e mjedisit	
	1	Specialist per administrimin e rregjistrimit te territorit	
Nëpunësa civilë - total		<b>4</b>	
<b>6</b>	1	Drejtor	Kjo Drejtori ndryshoi emërtes në "Drejtorja e Sherbimeve dhe
	1	Specialist i fushes kultures, artit dhe sportive	
	1	Specialist i bujqësisë dhe agrikultures	



		1	Specialist i emergjencave dhe sherbimeve	Planifikimit të Territorit* dhe shtoi 1 pozicin pune
		1	Specialist i çeshtjeve sociale	
		1	Specialist i mjedisit dhe turizmit	
Nëpunësa civilë - total		6		
		1	Drejtor	Drejtoria Menaxhimit te Burimeve Njerezore u bashkua me Drejtorin Juridike dhe Finances. Nga ky bashkim, nga 7 nëpunësa civil që kishin Drejtoritë bashkë ngelën 5, u suprimuan 2 pozicione
		1	Specialist per burimet njerezore	
	Drejtoria Menaxhimit te Burimeve Njerezore	1	Specialist i Zyres se Arkivit (P. Administrativ)	
		1	Pergjegjes per logjistikën	
		1	Shofer administrate (P. Administrativ)	
		1	Roje operative (P. Administrativ)	
		1	Sanitare (P. Administrativ)	
		3	Mirmbajtjes dhe Roje Operative (P. Administrativ)	
Nëpunësa civilë - total		3		
		1	Kryeinspektor	Ky inspektoriat u shkri me ligjin nr. 183/2014, "Për inspektimin e ndërtimit".
	Inspektoriat Ndertimit dhe Urbanistik	1	Inspektor	
		1	Inspektor	
Nëpunësa civilë - total		3		
		1	Kryeinspektor	Ndryshoi emërtes në "IMT dhe Ndërtimit", dhe shtoi 1 pozicin pune.
	Inspektoriat i Mbrojtjes Tokes	1	Inspektor	
		1	Inspektor	
Nëpunësa civilë total		3		
		2	Operator - DAMT dhe MBNJ	U pakësua me një punonjës me kontrat.
	Punonjës kontratë përkohshme	1	Operator në funksion të projekteve sociale	

#### I. FUNKSIONE TE DELEGUARA

		1	Drejtor i D.A.M.T	D.A.M.T nuk ndryshoi.
	D.A.M.T	3	Pergjegjes zyre	
		1	Specialist	
Nëpunësa civilë - total		5		

Një muaj mbas miratimit të vendimit nr. 47, datë 26.12.2014, Këshilli i Qarkut Kukës miraton me Vendimin nr. 2, datë 28.01.2015, strukturën aktuale organizative, e cila solli shkurtimin e mëtejshëm të pozicioneve të punës. Kjo strukturë administrative ka gjithsej 27 vende pune, nga ku: 5 funksionar politikë, 4 punonjës administrative, 2 punonjës me kontratë të përkohshme dhe 18 nëpunës civil (13 nëpunës civil të qarkut dhe 5 nëpunës civil të deleguar). Ky vendim parashikon shkurtimin e 9 vendeve pune, duke e shkurtuar kështu me 7 numrin e përgjithshëm të pozicioneve në shërbim civil.

Ndryshimet që solli vendimi nr. 2, datë 28.01.2015, paraqiten në tabelën më poshtë:

#### Struktura miratuar me vendimin nr. 47, datë 26.12.2014, dhe ndryshimet e që solli struktura miratuar me vendimin nr. 2, datë 28.01.2015.

I. FUNKSIONE TË QARKUT				
Nr.	Drejtoritë/ Sektorët	Nr. Pers.	Emërtesa e pozicionit të punës	Ndryshimet e bëra me VKQ nr. 2, datë 28.01.15
1	Të zgjedhur	1	Kryetar	
		1	N/Kryetar	
		1	Sekretar i K/Qarkut	
		1	Keshilltar per M.me Jashtë, Q.Vendore dhe OJF	
		1	Sekretare e Kryetarit dhe Marrëdhënieve me Publikun	
2	Drejtoria Juridike, Finances dhe Menaxhimit te Burimeve	1	Drejtor	Ndryshon vetëm pozicioni "Shef i Sektorit për llogjistikën dhe aktivitetet" me pozicionin "Specialist i administratës dhe
		1	Jurist	
		1	Shef i Sektorit Finances	
		1	Arkëtar, magazinier dhe arkiv (P. Administrativ)	
		1	Specialist MBNJ	

	Njerezore	1	Shef i Sektorit për llogjistikën dhe aktivitetet	<i>llogjistikës?</i>
		1	Shofer administrate (P. Administrativ)	
		1	Roje operative (P. Administrativ)	
		1	Sanitare (P. Administrativ)	
	Nëpunësa civilë - total	5		
3	Drejtoria e Tekno., Info. Prog. dhe Statistikave	1	Drejtor	Kjo drejtori nuk ka pësuar ndryshime
		1	Specialist i programimit dhe database	
		1	Specialist për statistikat dhe ëbsite	
		1	Specialist i administrimit të rrjetit	
	Nëpunësa civilë - total	4		
4	Drejtoria e Shërbimeve dhe Planifikimit të Territorit	1	Drejtor	Në këtë drejtori suprimohen tre pozicione të kategorisë "Specialist"
		1	Specialist i planifikimit të territorit	
		1	Specialist i arsimit, kulturës dhe sporteve	
		1	Specialist i bujqësisë, pyjeve dhe kullotave	
		1	Specialist i emergjencave dhe shërbimeve	
		1	Specialist i çështjeve sociale	
	Nëpunësa civilë - total	7		
5	Inspektoriati i Mbrojtjes Tokës dhe Ndërtimit	1	Kryeinspektor	Ky inspektoriat u shkri me VKQ nr. 2, datë 28.01.2015.
		1	Inspektor	
		1	Inspektor	
		1	Inspektor	
	Nëpunësa civilë - total	4		
10	Punonjës kontratë përkohshme	1	Operator	
		1	Operator	

#### I. FUNKSIONE TE DELEGUARA

	D.A.M.T	1	Drejtor i D.A.M.T	D.A.M.T nuk ndryshoi.
		3	Përgjegjës zyre	
		1	Specialist	
	Nëpunësa civilë - total	5		

#### ➤ Komisioni i Ristrukturimit

Nga krahasimi i strukturave arrihet në konkluzionin se institucioni, Këshilli i Qarkut Kukës ka kaluar një proces të plotë restrukturimi, pasi konstatohet plotësimi i të dy kërkesave të ligjit për të pasur një proces restrukturimi: shkurtimi i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe ndryshimi i strukturës së pozicioneve të punës dhe asaj organizative.

Nga shqyrtimi i dokumentave që materializojnë procesin e restrukturimit, arrijmë në përfundimin se njësisia e burimeve njerëzore, ka ngritur vetëm një Komision Ristrukturimi, për implementimin e të dyja strukturave të administratës të miratuara nga Këshilli i Qarkut me një muaj diferencë, për shkak të kohës së shkurtër që ka kaluar nga miratimi i dy strukturave të analizuara më sipër.

Me urdhërin nr. 8, datë 06.01.2015, të Kryetarit, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, për efekt të ndryshimit dhe pakësimit të vendeve të punës në strukturën organike të Këshillit të Qarkut Kukës, përbërja e të cilit është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit.

Antarët e këtij komisioni janë:

1. \*\*\*\*\* Drejtor i Drejtorisë Juridike, Financës dhe Burimeve Njerëzore –Kryetar
2. \*\*\*\*\* Drejtor i Shërbimeve dhe Planifikimit të Territorit – Antar
3. \*\*\*\*\* Specialist i Burimeve Njerëzore, DJFMBNJ – Antar

Detyrat e komisionit të ristrukturimit në atë kohë kanë qenë:

- Shqyrtimi i mundësive të sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e mbetura pas riorganizimit;
- Propozimi i transferimit të nëpunësve në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori;
- Propozimi për lirim nga detyra të atyre nëpunësve të cilëve u shkurtohet pozicioni i punës, ose që nuk mund të sistemohen për shkak se nuk plotësojnë kërkesat e përgjithëshme e të veçanta të ndonjërit prej pozicioneve të mbetura;

Komisioni i Ristrukturimit ka hartuar vendimet për propozimin e transferimit të nëpunësve civil, duke bërë krahasimin e përputhjes së kriterëve që plotësojnë kandidatëve me kriteret specifike të vendeve të lira apo vendeve të reja të krijuara me strukturën e re.

Në përfundim, Kryetari i Këshillit të Qarkut Kukës ka miratuar propozimet e Komisionit të Ristrukturimit, e konkretisht:

- Nëpunësit civilë që u sistemuan në vendet e lira ekzistuese, që plotësonin kërkesat e përgjithëshme e të veçanta për vendet e punës të mbetura, apo ristrukturuara dhe që u preferuan prej komisionit të ristrukturimit, për shkak të kualifikimit dhe eksperiencës në punë, janë:

Funksione të Qarkut

1. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 2, datë 06.01.2015, emërohet *Drejtor i DJFMBNJ*;
2. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 3, datë 06.01.2015, emërohet *Shef i Sektorit të Financës*;
3. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 4, datë 06.01.2015, emërohet *Specialist i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*;
4. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 9, datë 07.01.2015, emërohet *Jurist në D.J.F.M.B.NJ*;
5. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 11, datë 07.01.2015, emërohet *Shef i Sektorit për Logjistikën dhe Aktivitetet në D.J.F.M.B.NJ*;
6. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 5, datë 06.01.2015, emërohet në pozicionin e *Drejtorit të DTIPS*;
7. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 16, datë 07.01.2015, emërohet *Specialist për Eeb dhe Multimedia në DTIPS*;
8. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 17, datë 07.01.2015, emërohet *Specialist i Administrimit të Rrjetit IT në DTIPS*;
9. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 15, datë 07.01.2015, emërohet *Specialist për Programin dhe Databaze në DTIPS*;
10. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 6, datë 06.01.2015, emërohet *Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Planifikimit të Territorit*;
11. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 23, datë 07.01.2015, emërohet *Specialist i Mjedisit dhe Turizmit në DSHPT*;
12. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 18, datë 07.01.2015, emërohet *Specialist i Planifikimit të Territorit në DSHPT*;
13. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 21, datë 07.01.2015, emërohet si *Specialist i Emergjencave dhe Shërbimeve në DSHPT*;

Funksione të Deleguara

14. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 4, datë 05.01.2011 emërohet *Drejtor pranë DAMT*;
  15. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 110, datë 01.04.2008 emërohet *Specialist në DAMT-Kukës*;
  16. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 21, datë 30.06.2006 emërohet *Përgjegjës i ZAMT-Kukës*;
  17. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 18, datë 01.06.2006 emërohet *Përgjegjës i ZAMT-Has*;
  18. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 32, datë 27.03.2015, emërohet *Përgjegjës i ZAMT-Tropojë*;
- Nëpunësit civil të larguar nga shërbimi civil si pasoje e ristrukturimit në administratën e Këshillit të Qarkut Kukës, sipas përcaktimeve të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" paraqiten si më poshtë:
    1. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 33, datë 07.01.2015 (efektet filluan në datën 31.01.2015) lirohet nga detyra e *Specialistit për Statistikat dhe Ëeb në DTIPS*;
    2. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 41, datë 30.01.2015 (efektet filluan në datën 31.01.2015) lirohet nga detyra e *Specialistit të Çështjeve Sociale në DSHPT*;
    3. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 38, datë 08.01.2015 (efektet filluan në datën 31.01.2015) lirohet nga detyra e *Inspektorit të INU-së*;
    4. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 45, datë 30.01.2015 (efektet filluan në datën 31.01.2015) lirohet nga detyra e *Inspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës dhe Ndërtimit*;
    5. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 43, datë 30.01.2015 (efektet filluan në datën 31.01.2015) lirohet nga detyra e *Inspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës dhe Ndërtimit*;
    6. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 42, datë 30.01.2015 (efektet filluan në datën 31.01.2015) lirohet nga detyra e *Specialistit të Arsimit, Kulturës, Sporteve në DSHPT*;
    7. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 29, datë 07.01.2015, lirohet nga detyra e *Drejtorit të Agjencisë së Zhvillimit Rajonal*;
    8. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 30, datë 07.01.2015, lirohet nga detyra *Specialist për Zbatimin e Strategjive dhe Investimeve pranë Agjencisë së Zhvillimit Rajonal*;
    9. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 31, datë 07.01.2015, lirohet nga detyra e *Specialist për Projektet në fushën e Ekonomisë pranë AZHR-së*;
    10. \*\*\*\*\* *Specialist për projekte Sociale dhe Mjedisin pranë Agjencisë së Zhvillimit Rajonal*;
    11. \*\*\*\*\* me urdhërin nr. 32, datë 07.01.2015, lirohet nga detyra *Specialist për Qendrën e Informacionit Turistik pranë Agjencisë së Zhvillimit Rajonal*;
    12. \*\*\*\*\* <sup>1</sup> larguar nga shërbimi civil dhe me urdhërin nr. 100, datë 27.04.2015, emërohet, përkohësisht, *Inspektor i Mbrojtjes së Tokës pranë DAMT-së*;
    13. \*\*\*\*\* <sup>2</sup> larguar nga shërbimi civil dhe me urdhërin nr. 50, datë 30.01.2015, emërohet përkohësisht, *Inspektor i Mbrojtjes së Tokës pranë DAMT-së*.

<sup>1</sup> Punonjës me kontratë të përkohëshme sipas përcaktimit të vendimit nr. 5 datë 15.04.2015<sup>1</sup> "Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e administratës së KQK-së"

Punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, me të drejtë nuk janë trajtuar financiarisht, duke mos përfituar dëmshperblim siç parashikon neni 50 pika 7 e ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, pasi shkurtimi i pozicioneve të tyre është bërë përpara datës 29.01.2014, që është data e fillimit të efekteve të ligjit nr.178/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" (data 29.01.2014) si dhe udhëzimit përkatës të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 09.01.2015, dalë në bazë e për zbatim të tij.

Për më tepër, dy nëpunësit civil të liruar nga shërbimi civil ( \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* ) vazhdojnë marrëdhënien e punës në institucionin e inspektuar në pozicionet e punës sipas strukturës, me kontratë të përkohshme dhe nuk janë pjesë e shërbimit civil në sektorin e Inspektoriatit për Mbrojtjen e Tokës pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

Komisioneri për Mbikëqyrien e Shërbimit Civil për këtë proces ristrukturimi konstaton se:

Procesi i ristrukturimit në përgjithësi është kryer në përputhje me ligjin. Vendimet e lirimt dhe riemërimit të nëpunësve civilë aktualë, janë hartuar në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të Këshillit të Ministrave.

Komisioni i Ristrukturimit pasi ka përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimin nr. 171, dt. 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave, ka bërë propozimet përkatëse para njësisë të personelit për sistemimin në punë të punonjësve më të përshtatshëm.

Urdhërat për riemërimet, kanë dalë pasi Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar dokumentacionin e nevojshëm ligjor (*dosjen personale*), përshkrimet e punës së pozicioneve të ristrukturuara, kriteret specifike të vendeve të lira të krijuara, vlerësimin vjetor dhe vjetërsinë në punë të secilit nëpunës. Njësia e personelit, pasi ka vlerësuar vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit si të drejtë, si dhe duke u bazuar në ligj, i ka miratuar propozimet dhe ka nxjerrë aktet e riemërimit pas ristrukturimit, për të gjithë punonjësit e prekur nga ky proces.

Komisioneri vlerëson se, aktet e lirimt të nxjerra nga njësia përgjegjëse, nga pikpamja procedurale, kanë dalë në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil" të Këshillit të Ministrave, Kreu III "Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit" dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të Këshillit të Ministrave.

- o Por nga ana tjetër konstatohet se në raste të veçanta, është ometuar në respektimin e disa kërkesave të karakterit plotësues, të procesit të ristrukturimit. Konkretisht:
  1. Në rastet kur ka pasur ulje në detyrë të punonjësve pas riemërimit, për shkak të shkurtimit të vendit të punës, apo ristrukturimit të pozicionit, nuk është marrë mendimi me shkrim i

<sup>7</sup> Punonjës me kontratë të përkohshme sipas përcaktimit të vendimit nr. 5 datë 15.04.2015" Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e administratës së KQK-së"

nëpunësit, për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III, "Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit", të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", por kjo parregullsi nuk e bën të pavlefshëm vendimin e emërimit, i cili i plotëson kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave, Kreu III "Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit" dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të Këshillit të Ministrave.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të plotësojë menjëherë rastin me aktin e pëlqimit me shkrim të punonjësit që ka ndryshuar pozicionin e punës dhe të administrohet në dosjet e nëpunësve përkatës.

- o Ndërkohë, konstatohet se në I rast, Komisioni i Ristrukturimit në procedurat e ndjekura për propozimin e transferimit të punonjësve nuk ka respektuar kërkesat e ligjit, konkretisht:

1. Propozimi i Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e \*\*\*\*\* nga pozicioni "Specialist për Kontrollin dhe Zhvillimin e Tokës në Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit" në pozicionin "Përgjegjës e Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Tropojë" miratuar me aktin nr. 32, datë 27.03.2015, të Kryetarit, nuk është bërë në respektim të kërkesave të ligjit. Sipas dispozitave të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, një nëpunës civil për të kaluar nga kategoria ekzekutive "Specialist" në kategorinë e nëpunësit të nivelit të ulët drejtues "Shef/Përgjegjës sektori" duhet të aplikohen procedurat e ngritjes në detyrë.

Ky propozim i Komisionit të Ristrukturimit dhe urdhëri për emërimin e kësaj nëpunëseje në pozicionin "Përgjegjës e Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Tropojë" nuk është kryer në përputhje me nenin 50, pika 1, e ligjit. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ku citohet se: "Nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori", pasi në këtë rast punonjësja është emëruar në një pozicion të një kategorie më të lartë, ç'ka mund të realizohet vetëm nëpërmjet procesit të ngritjes në detyrë, në këtë rast.

### **Konkluzione:**

Në këto rrethana, duke u nisur nga parregullsitë e përmendura më sipër, të cilat qëndrojnë në mosrespektim të kërkesave të ligjit në kuptimin formal të tij, por të asaj natyre që nuk e çënojnë ligjshmërinë në përmbajtjen e procesit administrativ dhe vendimmarjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se duhet të kryhen disa veprimeve administrative, për rregullimin e tyre, prandaj në këtë rast njësia përgjegjëse duhet të veprojë si më poshtë:

- Të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit, sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III "Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit", të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil" dhe të administrojë atë në dosjen e personelit (dosje individuale).

- Të revokohet akti nr. 32, datë 27.03.2015, i Kryetarit, për emërimin e nëpunëses \*\*\*\*  
\*\*\*\*\* në detyrën "Përgjegjëse në Zyrën e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës,  
Tropojë", si akt emërimi i nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Të meren masa nga njësia e  
burimeve njerëzore për të shpallur vëndin të lirë dhe të fillojë procedurën e rekrutimit në  
përputhje me kërkesat e ligjit.

## 5.2) Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes.

Vihet re se, për periudhën objekt inspektimi në institucionin e kontrolluar, vetëm në 1 rast, ka përfunduar marrëdhënia e punës në shërbimin civil nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes, sipas përcaktimeve të nenit 64, pika 1 dhe nenin 66, shkronja "dh", të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil".

Më konkretisht bëhet fjalë për nëpunësen \*\*\*\*\* e cila ka punuar në pozicionin e punës "Specialiste e Çështjeve Sociale", pranë Drejtorisë së Shërbimeve Rajonale. Kjo nëpunëse është larguar nga detyra me kërkesën e saj në muajin maj – 2014.

### 6) Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.)

U verifikuan dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se janë të përfshira dokumentet me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1, 2 dhe 3, bashkëlidhur aktit nënligjor që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se në çdo dosje janë të administruara dokumenti i identifikimit (fotokopje e letërnjoftimit); dokumenti mbi gjendjen civile (çertifikata e gjendjes familjare); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave); dokumentet që vërtetojnë datën e fillimit të punës në pozicionin përkatës (akti i emërimit); dokumenti i vërtetimit të gjendjes gjyqësore; etj.

Plotësimi i këtyre kërkesave është pasqyruar për secilin nëpunës në anekset që i bashkëlidhen raportit, si pjesë e tij.

Në kushtet e parashtruara më sipër, si dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit në administrimin e shërbimit civil, Komisioneri vlerëson se njësia e burimeve njerëzore, duhet të punojë me procesin e plotësimit të dosjeve në këto drejtime:

1. Të plotësohet fleta prezantuese dhe ti bashkangjitet dosjes teknike të nëpunësit sipas lidhjes nr. 2 "Të dhënat që duhet të përmbajë fleta prezantuese e dosjes teknike të nëpunësit" bashkangjitur vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", të Këshillit të Ministrave.

2. Të plotësohet dosja me të gjitha aktet e emërimit që pasqyrojnë në mënyrë kronologjike lëvizjet e nëpunësit, nga momenti fillimit të marrëdhënieve juridike të punës dhe atyre financiare e në vijim (*aktet që pasqyrojnë ndryshim të pozicionit të punës, strukturim të pozicionit të punës, ndryshim të kategorisë së pozicionit të punës etj. ndryshime që lidhen me pozicionin e punës*), të cilat duhet të administrohen në një ndarje të veçantë të dosjes individuale të nëpunësit.
3. Përshkrimet e punës, dhe vlerësimet e punës të plotësuara në mënyrën e duhur dhe të nënshkruara nga nëpunësit/strukturat kompetente (*të hartuara, të nënshkruara dhe të formalizuara si çdo dokument tjetër zyrtar*) duhet të administrohen në dosjen e individuale të nëpunësit civil.  
Kjo për faktin se, përshkrimi i punës dhe vlerësimi i punës në rubrikat apo në ndarjet e tyre trajtojnë elemente të ndryshme që kanë lidhje me gjithë dinamikën e karrierës së nëpunësit civil, ndër të cilat, kërkesat e posaçme të vendit të punës, nivelin e arsimit, fushën kryesore të studimeve, përvojën në punë, njohuritë dhe aftësitë e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për pozicionin e punës etj.

**Konkluzion:** Komisioneri, në lidhje me ruajtjen dhe administrimin e dosjeve, konstaton se ato janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore. Nga ana tjetër, duhet të vijojë puna për të plotësuar dosjen e personelit me kërkesat e parashtruara më sipër si dhe me dokumentet e evidentuara në aneksin përkatës bashkëngjitur raportit.

\*  
\* \* \*

Këto ish-in rrethanat e konstatuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil gjatë procesit të inspektimit në Këshillin e Qarkut Kukës në lidhje me monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat:

- Aneksi nr. 1 *Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të punësuar me emërim të përkohshëm (data 26.02.2014).*
- Aneksi nr. 2 *Respektimi i kërkesave të përgjithëshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion.*
- Aneksi nr. 3 *Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të punësuar nëpërmjet konkurimit (data 26.02.2014).*
- Aneksi nr. 4 *Vazhdimësia në shërbimin civil për nëpunësit dhe punonjësit që kryejnë funksione të shërbimit civil në Këshillin e Qarkut Kukës.*

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**



Pranoi

DREJTORI I INSPEKTIMIT DHE  
HETIMIT ADMINISTRATIV

Ilia KUKUMI

  
O p o n e n c a

DREJTOR I ÇËSHTJEVE JURIDIKE  
DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Enkelejda HEBIBASI

Miratohet



DREJTOR I PËRGJITHSHËM I  
MBIKËQYRJES DHE INSPEKTIMIT

Arbana BASHA



Punoi, grupi i inspektimit

Saimir MUÇMATAJ – Përgjegjës Grupi

Atalvin NIÇO - Anëtar

Stela NDOKA - Anëtar

